

LIGJ
Nr.9627, datë 30.10.2006

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA KOMITETI QEVERTAR I
BISEDIMIT TË BORXHIT TË JASHTËM DHE SHOQËRISË “MALI”, GJAKOVË, PËR
RISKEDULIMIN E BORXHIT TË PRAPAMBETUR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Komiteti Qeveritar i Bisedimit të Borxhit të Jashtëm dhe Shoqërisë “Mali”, Gjakovë, për riskedulimin e borxhit të prapambetur”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5113, datë 20.11.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
PËRFAQËSUAR NGA KOMITETI QEVERTAR I BISEDIMIT TË BORXHIT TË JASHTËM,
DHE KOMPANISË “MALI” GJAKOVË LIDHUR ME RISKEDULIMIN E BORXHIT TË
PRAPAMBETUR

Marrëveshje, datë 1.9.2006, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (Këshilli), i përfaqësuar nga Komiteti Qeveritar i Bisedimit të Borxhit të Jashtëm (KQBBJ) dhe kompanisë “Mali” Gjakovë.

Neni 1

Subjekt i kësaj Marrëveshjeje është riskedulimi i detyrimeve të prapambetura të “Kukësimpeks” Kukës, kundrejt kompanisë “Mali” Gjakovë, që rrjedhin nga transaksionet tregtare të realizuara gjatë vitit 1991.

Shuma e detyrimit arrin në 60 157,10 Clg.USD.

Neni 2

Të dyja Palët bien dakord që 1 Clg.USD të konvertohet në USD me kursin 1 Clg.USD = 1 USD.

Shuma e detyrimit për t'u paguar është 60 157,10 USD.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë angazhohet t'i paguajë kompanisë “Mali” Gjakovë detyrimin prej 60 157.10 USD, me një kësht të vetëm, menjëherë me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Pagesat do të kryhen në llogarinë bankare që do të njoftohet me shkrim nga kompania “Mali” Gjakovë.

Neni 4

Kjo Marrëveshje nuk mund të ndryshohet pa rënien dakord me shkrim nga të dyja Palët.

Neni 5

Për çdo problem, Palët do të komunikojnë me njëra-tjetrën me shkrim në gjuhën shqipe, në adresat e mëposhtme:

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr.1
Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 228405